



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.58 dt.27.03.1997

**“MBI
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN JANAR 1997”.**

Në bazë të legjislacionit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.27.03.1997, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Zyrës së Asistencës Sociale

V E N D O S I;

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **11704 familje** gjithsej me një fond prej **24.889.037 lekë**. Për çdo njësi administrative sipas relacionit.
2. Miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje për muajin Janar.
3. Të dalin nga skema e ndihmës ekonomike **159 familje** sipas pasqyrave të bashkëngjitura.
4. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike Elvira Lami, familje me 3 antarë, ndihmë ekonomike e plotë, Nj.A.5.
5. Të trajtohen me ndihmë ekonomike si raste të veçanta Lulzime Deda, familje me 5 antarë dhe Sokol Shahini, me 6 antarë, të Nj.A.1, në bazë të ligjit Nr.8008, dt.05.10.1995.
6. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1380 persona** me aftësi të kufizuar dhe **53 persona** për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar në një fond gjithsej prej **4.672.366 lekë**.
7. Të miratohen dokumentat dhe kriteret për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve pa të ardhura si rezultat i falimentimit të firmave rentiere.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI